



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:161534

Datë: 22.04.2024

Numri i dokumentit: 05721798

P.nr.233/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Petrit Nrecaj, me procesmbajtësen Hale Ahmetaj, në çështjen penale kundër të pandehurve Sh.M, i akuzuar për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 par.3 lidhur me par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), dhe të pandehurit B.R i akuzuar për shkak të veprës penale deklaramet e rreme nga neni 384 par.1 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.1487/22 të datës 08.08.2022, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar më datë **25.03.2024**, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Dorjan Juniku, të pandehurit Sh.M se bashku me mbrojtësin e tij av. Astrit Bekaj, dhe të pandehurit B.R, të njëjtën ditë mori dhe shpalli, ndërsa me datë 22.04.2024 përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. I pandehuri: Sh.M,** nga i ati Isa dhe e ëma C. e gjinisë T., i lindur me datë ..., në fshatin O., ku edhe banon rr. “Artarët e Lirisë” Komuna e Istogut, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka te kryer 7 vite të shkollës fillore, i pa punë, me gjende të dobët ekonomike, me numër personal..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
- 2. I pandehuri: B.R** nga i ati D. dhe e ëma A., e gjinisë G., i lindur me datë në P., tani me banim në fshatin V.rr. “H.H” pn, Komuna Pejë, Rajoni III, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, me gjendej të dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse:

I pandehuri Sh.M:

- I. Me datë 16.07.2022, rreth orës 01:40 minuta, në fshatin Carallukë, Komuna Istog, me fjalë i kanos zyrtarët policor lidhur me punën zyrtare se do t'i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit dhe atë të dëmtuarve H.H dhe B.Z, në atë mënyrë që, gjersa zyrtarët në fjalë ishin dal në vendin e ngjarjes pasi ishin informuar për një rast me vetë aksident dhe gjer sa zyrtarët policor ishin duke pritur njësitin e trafikut për të dal ne vendin e ngjarjes, i pandehuri kishte tentuar që të largohet nga vendi i ngjarjes duke ofenduar dhe gjatë gjithë kohës kishte bërë titur në zë të lartë dhe pasi zyrtarët policor kishin arritur ta vënë situatën në kontroll duke arrestuar të dyshuarin dhe duke e futur ne veturë për ta dërguar për në Stacionin policor, i pandehuri i është drejtuar me fjalë “keni me marr vesh kush jam unë” me çka tek këta të fundit shkakton frikë dhe panik.

- me çka ka kryer vepër penale **kanosje nga neni 384 par.1 të KPRK-së.**

I pandehuri B.R:

- II. Me datë 16.07.2022, rreth orës 01:40 minuta në Stacionin Policor në Istog, në cilësinë e dëshmitarit në procedurën paraprake jep deklaram të rremë në atë mënyrë që me datë 16.07.2022, pranë stacionit policor në Istog kishte deklaruar se “*Sh.M i cili ishte duke e drejtuar veturën e tij dhe me të arritur në fshatin C. papritmas një veturë në përball-kalim kishte kaluar po thuajse në shiritin e rrugës dhe për t'i shmangur aksidentit Sh. e kishte lëshuar rrugën ku në atë rast ka dal nga rruga dhe kemi renë në një kanal në skaj të rrugës, ndërsa me datë 22.07.2022 pran stacionit policor në Pejë ka deklaruar “unë kam vozitur veturën e S. dhe diku në hyrje të fshatit C. duke shikuar se si është gjendja e Shkodranit kam devijuar nga rruga dhe kam rënë në kanal, deklarim ky ku i pandehuri kishte pasur për qëllim që këtu të dyshuarit Shkodran te mos i merret patentë shoferi nga zyrtaret policor.*

- me çka ka kryer vepër penale **deklarimet e rreme nga neni 384 par. 1 të KPRK-së.**

Gjykata duke u bazuar në nenin e lartcekur dhe dispozitat e nenit 2, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42,46, 47, 48, 49, 69, 79 të KPRK-së dhe nenit 242, 364, 459 të Kodit të Procedurës Penale (tutje KPP-së), të pandehurit i:

GJYKON

- I. Ashtu që, të pandehurit **Sh.M**, i shqiptohet dënimi më burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajsh, *i cili dënim do të jetë i kushtëzuar, nuk do të ekzekutohet* nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
- II. Ashtu që, të pandehurit **B.R**, i shqiptohet dënimi më gjobë në shumë prej pesëqind (500) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) muaji, *të cilat dënime do të jenë të kushtëzuara, nuk do të ekzekutohen* nëse i pandehuri brenda periudhës së verifikimit në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.
- III. Nëse, të pandehurit brenda periudhës së lartcekur të verifikimit kryejnë vepër tjetër penale, atëherë gjykata në bazë të nenit 50 të KPRK-së, do t'a revokon dënimin me kusht dhe ndaj personit të dënuar do të ekzekutohet dënimi i cili ka qenë i kushtëzuar me burgim dhe gjobë.
- IV. **OBLIGOHEN** të pandehurit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, të paguajnë secili veç e veç paushallin gjyqësor në shumë nga **njëzetë (20) euro**, ndërsa në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë nga **njëzetë (20) euro**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- V. **Palët e dëmtuara:** H.H me vendbanim ne rr."Qershori" Panorama 3, banesa nr.9, Komuna Istog dhe B.Z, me vendbanim në fshatin K. rr. "Diaspora" nr.84 Komuna Istog, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Rrjedha e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.1487/22 të datës 08.08.2022, kundër të pandehurit Sh.M për shkak të veprës penale kanosja nga neni 181 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe kundër të pandehurit B.R për shkak të veprës penale deklarimet e rreme nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me datë 25.03.2024 në të cilën seancë kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Dorjan Juniku dhe të pandehurit Sh.M se bashku me mbrojtësin e tij av. Astrit Bekaj i caktuar sipas autorizimit, dhe i pandehuri B.R, ku pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjykata pasi që është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar akuzën, dhe pas njoftimit me benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, i ka mundësuar të pandehurve të deklarohet për pranimin e fajësisë apo të deklarohen të pafajshëm.

I pandehuri Sh.M., pas konsultimit me mbrojtësin e tij av. Astrit Bekaj ka deklaruar: se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, jam vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e bëj në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është pënduar për këto veprime dhe i premtom gjykatës se ne të ardhmen do të këtë sjellje të mira dh nuk do të kryej vepra penale.

I pandehuri B.R ka deklaruar: se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e fajësisë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion nga askush, duke shtuar se është pënduar për këto veprime dhe i premtom gjykatës se ne të ardhmen do të këtë sjellje të mira dh nuk do të kryej vepra penale.

Prokurori i Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit, ka deklaruar: pajtohem me pranimin e fajësisë te deklaruar nga ana e te pandehurve për veprat penale për të cilat akuzohen, andaj kërkojmë qe ky pranim fajësie të aprovohet si i tillë.

Mbrojtësi i të pandehurit Sh.M, av. Astrit Bekaj, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, ka deklaruar: sa i përket pranimin të fajësisë nga i mbrojturi im e mbështesim pranimin e fajësisë dhe i propozoj gjykatës qe ta aprovoj pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim pasi qe jam konsultuar mjaftueshëm me të njëjtin, po ashtu i mbrojturi im i ka kuptuar benifitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, ky pranim fajësie është në përputhje me provat qe gjenden në shkresat e lëndës, kurse me rastin e matjes dhe lartësisë së dënimit i propozoj gjykatës qe si rrethanë veçanërisht lehtësuese të marr faktin se i njëjti ka bashkëpunuar qe nga fillimi i kësaj procedure, po ashtu i mbrojturi im ka ndier keqardhje për rastin qe ka ndodhur dhe është pënduar thellë, dhe i propozoj gjykatës qe te mbrojturit tim t'i shqiptoj një dënim me vërejtje gjyqësore apo dënim të kushtëzuar i cili dënim to ta arrijë qëllimin e dënimit.

Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Gjykata ne rastin konkret lidhur me pranimin e fajësisë nga të pandehurit, pas marrjes së mendimeve te lartcekura, si dhe se pas vërtetimit se janë përmbushur kërkesat nga neni 242 par. 1, par. 2 nën par. 2.1, 2.2 dhe 2.3, dhe par.3 të KPP-së, përkatësisht pas vlerësimit se të pandehurit e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe se mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, po ashtu pas vërtetimit se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike të paraparë me nenin 242 par. 2, nën par. 2.4 të KPP-së, gjykata ka pranuar pranimin e fajësisë nga të pandehurit për veprat penale të lartcekura për te cilat janë akuzuar.

Vendimi për shpalljen fajtor

Gjykata nga të lartcekurat ka vendosur që të pandehurit t'i shpall fajtor për veprat penale për te cilat janë akuzuar dhe i ka gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjeti se të njëjtit janë penalisht përgjegjës dhe se nuk ekzistojnë rrethana të cilat i përjashtojnë përgjegjësitë penale të të pandehurve, po ashtu në veprimet e tyre manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të veprave penale të lartcekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pas pranimit të fajësisë nga të pandehurit dhe konstatimit nga gjykata të përmbushjes së kushteve në referim të nenit 242 par. 1, 2 dhe 3 të KPP-së, gjykata ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Rrethanat që janë marre për bazë me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit sa i përket sanksionit penal, përkatësisht me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, vlerësoi të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese, të cilat konform nenit 69 të KPRK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që, për të pandehurin **Sh.M** si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se ka pranuar fajësinë dhe rrethanat personale se është penduar për këto veprime, premtimin se ne te ardhmen do të ketë sjellje të mira dhe është mbajtës i familjes, ndërsa **rrethana rëndues** nuk ka gjetur; për të pandehurin **B.R** si **rrethana lehtësuese** ka gjetur se ka pranuar fajësinë dhe rrethanat personale se është penduar për këto veprime, premtimin se ne te ardhmen do të ketë sjellje të mira dhe është mbajtës i familjes, ndërsa **rrethana rëndues** nuk ka gjetur. Andaj, Gjykata në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurve, të cilët do ta kuptojnë rëndësinë e veprës penale të cilën e kanë kryer dhe në këtë mënyrë të njëjtit do të reflektojnë që në të ardhmen mos të shkaktojnë veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryejnë vepra penale, si dhe do të ndikojnë tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimet e shqiptuara dhe të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndaj këtu të pandehurve, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen nëse te pandehurit në afat prej një (1) viti, nga dita kur ky aktgjykim merr formën e prerë, nuk kryejnë ndonjë veprë tjetër penale. Janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurve, me të cilat dënime do të arrihet edhe qëllimi i dënimit me kusht sipas nenit 47 të KPRK-së, përkatësisht që të mos zbatohet dënimi për vepra penale kur vlerësohet se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënimit është e mjaftueshme të ndalojë që kryesi të mos kryejë vepra penale.

Gjykata, të pandehurve me anë të pezullimit të ekzekutimit të dënimeve me burgim dhe gjobë, i'a tërheq vërejtjen seriozisht dhe i'u bëhet me dije se nëse kryejnë vepra tjetër penale gjatë periudhës kohore të verifikimit, dënimi i cili ka qenë i kushtëzuar për një kohë të caktuar, do të ekzekutohet.

Shpenzimet e procedurës

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 452 par. 1 dhe nenit 449 par. 2 të KPP-së, e ngarkoi të akuzuarit me shpenzimet e procedurës të precizuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e po ashtu konform të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të

Krimet, i obligoi të paguajn shumën nga 20 euro në emër të taksës për programin për kompensimin e viktimave të krimet.

Udhëzimi i palës së dëmtuar për kërkesat pasurore-juridike

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil, është marr konform nenit 462 par.2 të KPP-së.

Gjykata duke u bazuar në arsyet e lartshënuara e në bazë të neneve 242, 364 dhe 369 të KPP-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

Procesmbajtësja
Hale Ahmetaj

GJYQTARI
Petrit Nrecaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovë në Prishtinë, *në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.*